



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 10 dhjetor 2012  
Nr. ref.:VTK327/12

## VENDIM PËR HEQJE TË KËRKESËS NGA LISTA

në

Rastin KO63/12

**Kërkesa e Alma Lamës dhe e 10 deputetëve të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-82**

### GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga

Enver Hasani, Kryetar  
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### Parashtruesit e kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë deputetët e Kuvendit të Kosovës: Alma Lama, Visar Ymeri, Rexhep Selimi, Afrim Kasolli, Albulena Haxhiu, Albana Fetoshi, Albana Gashi, Glauk Konjufca, Albin Kurti, Florin Krasniqi dhe Afrim Hoti.

## Objekti i çështjes

2. Kërkesa ka të bëjë me kushtetutshmërinë e neneve 37, 38 dhe 39 të **Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-82** (në tekstin e mëtejshëm: Kodi Penal), të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, më 20 prill 2012, dhe të shpallur me vendim të Kuvendit më 22 qershor 2012.
3. Më saktësisht, parashtruesit e kërkesës i shtrojnë këtë pyetje Gjykatës Kushtetuese: “*A cenojnë nenet 37, 38, 39 të Kodit Nr. 04-L-082 Penal të Republikës së Kosovës të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Nenet 40 dhe 42 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe me Nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollet e saj*”.

## Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), në nenin 20 dhe 43 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

## Procedura në Gjykatë pas nxjerrjes së Vendimit për Pranueshmëri dhe Shtyrje nr. ref. VP318/12 i publikuar më 29 tetor 2012

5. Më 18 tetor 2012 Gjykata Kushtetuese vendosi ta shpallë kërkesën të pranueshme, të shtyjë vendimin për meritat e kërkesës deri më 15 dhjetor 2012 dhe të mbetet e përkushtuar në këtë çështje.
6. Përveç kësaj, Gjykata kërkoi nga Kuvendi i Kosovës informacione për statusin e procedurës legislative në lidhje me heqjen e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal, Ligjit nr. 04/L-82 të Republikës së Kosovës.
7. Më 12 nëntor 2012, Gjykata Kushtetuese e mori një letër nga Kryetari i Kuvendit të Republikës, me të cilën Gjykata njoftohet se “*Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbledhjen plenare të mbajtur më 19 tetor 2012, e ka miratuar Ligjin nr. 04/1-129 për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr. 04/L-082. Me miratimin e Ligjit nr. 04/1-129 janë shfuqizuar nenet 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës*”. Për më tepër, letrës së 12 nëntorit i ishte bashkëngjitur Dekreti DL-048-2012 për shpalljen e Ligjit nr. 04/1-129 për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës i 2 nëntorit 2012 i nënshkruar nga Presidenti i Republikës së Kosovës.
8. Më 15 nëntor 2012, Alma Lama dorëzoi një shkresë në Gjykatë me të cilën kërkon disa sqarime përkritazi me Vendimin për Pranueshmëri dhe Shtyrje.
9. Më 5 dhjetor 2012, Gjykata mbajti këshillime për meritat e kërkesës.

## Përmbledhja e fakteve pas nxjerrjes së Vendimit për Pranueshmëri dhe Shtyrje

10. Më 19 nëntor 2012, Kuvendi i Kosovës e miratoi Ligjin nr. 04/L-129 për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal të Kosovës, Ligji nr. 04/L-082, duke përcaktuar si në vijim:

*Neni 1*  
*Qëllimi*

*Ky ligj ka për*  
*Kosovës.*

*Neni 2*  
*Shfuqizimet në Kodin Penal të Republikës së Kosovës.*

*Nenet 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës hiqen.*

*Neni 3*  
*Hyrja*

*Ky ligj hyn në fuqi me 1 janar*

11. Më 29 tetor 2012, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës ia dorëzoi këtë ligj Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje.
12. Më 2 nëntor 2012, Kryetari i Republikës së Kosovës me Dekretin nr. DL-048-2012 e shpalli Ligjin nr. 04/L-129 për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

**Vlerësimi i meritave të kërkesës**

13. Kodi Penal i Kosovës duhet të hyjë në fuqi më 1 janar 2013, siç është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 20 prill 2012, dhe i shpallur me vendim të Kuvendit më 22 qershorit 2012.
14. Gjykata, në vendimin e saj për pranueshmëri dhe shtyrje mori parasysh se nenet e kontestuara 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal u miratuan nga Kuvendi i Kosovës më 20 prill 2012 dhe u shpallën me vendim të Kuvendit më 22 qershor 2012.
15. Sidoqoftë, dispozitat e kontestuara nga ana e parashtruesve të kërkesës u bënë objekt i një iniciative tjetër legislative, një debati dhe miratimi nga Kuvendi i Kosovës. Në të vërtetë ky proces legjislativ u përmbyll më 2 nëntor 2012 me shpalljen e Ligjit nr. 04/L-129.
16. Neni 2 i këtij Ligji me nr. 04/L-129 përcakton që “*Nenet 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës hiqen*” kurse në nenin 3 thuhet se “*Ky ligj hyn në fuqi me 1 janar*”
17. Prandaj, heqja e neneve 37, 38 dhe 39 nga Kodi Penal garantohej me hyrjen e njëkohëshme të Kodit Penal, Ligji nr. 04/L-082, dhe me Ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Ligjin nr. 04/L-129.
18. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se ky proces legjislativ është fakt i papritur që është relevant dhe ndikon në mënyrë substanciale në kërkesën e parashtruesve në bazat dhe themelësinë e saj.

## Vendimi për heqje nga lista

19. Gjykata konsideron se ngjarja e papritur legislative tregon se pozita e parashtruesve të kërkesës ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme. Pozita e tanishme është e tillë që kërkesa nuk ka arsyetim dhe qëllimi që kanë kërkuar të arrijnë është arritur plotësisht. Në dritën e kësaj, Gjykata konsideron se nuk ka më merita për të shqyrtuar më tutje këtë çështje.
20. Sidoqoftë, Gjykata e ka kompetencën dhe detyrën që të adresojë këtë çështje posaçërisht duke pasur parasysh Rregulloren e vet të punës.
21. Në të vërtetë, rregulli 32 (4) i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese thotë se Gjykata mund të hedhë poshtë një kërkesë kur konstaton se pretendimet janë pa objekt shqyrtimi apo nuk paraqesin më rast apo kontest. Ky rregull në pjesën relevante parashikon si në vijim:

### *Rregulli 32*

#### *Tërheqja e kërkesës dhe përgjigjes*

*(4) Gjykata mund të hedhë poshtë një kërkesë kur përcakton se pretendimet në të janë të diskutueshme ose që nuk përfaqësojnë një rast ose kontest.*

*(5) Sekretariati njofton të gjitha palët me shkrim për çfarëdo tërheqje, për çfarëdo vendimi të Gjykatës për të vendosur në lidhje me kërkesën, pavarësisht tërheqjes së saj, dhe për çfarëdo vendimi për ta hedhur poshtë kërkesën para vendimit përfundimtar.*

22. Po ashtu, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut në pjesën relevante parashikon si në vijim:

### **Neni 37 Çregjistrimi i kërkesave**

*1. Në çdo fazë të procedimit, Gjykata mund të vendosë të çregjistrojë një kërkesë, kur rrethanat çojnë në përfundimin se:*

- a. kërkuesi nuk ka ndërmend ta vazhdojë çështjen; ose*
- b. çështja është zgjidhur; ose*
- c. për çdo arsye tjetër që, sipas Gjykatës, nuk justifikon vazhdimin e shqyrtimit të kërkesës.*

23. Si parim i përgjithshëm procedural, Gjykata nuk duhet të nxjerrë vendime për raste ku çështja nuk ekziston më dhe rasti mbetet pa objekt shqyrtimi. Gjykatat nuk merren me raste hipotetike apo akademike. Ky është parim i pranuar botërisht për sjelljen e gjykatave dhe është analog me parimin e vetëpërmbytjes gjyqësore.
24. Për më tepër, Gjykata tashmë ka përcaktuar (në rastin 11/09, Vendimi nr. VHL112/11 të 30 majit 2012, paragrafi 46) se “Koncepti i të qenët pa objekt shqyrtimi është koncept i mirënjohur ligjor. Mund të paraqitet në një rast kur një çështje abstrakte apo hipotetike paraqitet për t'u vendosur në Gjykatë. Ka baza të mira që një Gjykatë të mos merret me situata hipotetike. Pa një çështje të vërtetë, të menjëhershme apo konkrete për të cilën duhet të vendoset, Gjykata mund të devijojë në marrjen e vendimeve që e obligojnë atë dhe publikun pa pasur arsye të mirë për të çfarëdo vendimi që Gjykata merr tani lidhur me këtë kërkesë nuk do të ketë efekt praktik”.

25. Duke marrë parasysh ngjarjen e papritur legislative që ka ndodhur dhe atë që u tha më lart, Gjykata konkludon se parashtruesit e kërkesës tani nuk kanë rast apo kontest të pazgjidhur në lidhje me kushtetutshmërinë e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal. Çështja është faktikisht pa objekt shqyrtimi.

### PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 32 (4) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese, njëzëri:

### VENDOS

- I. TA HEQË NGA LISTA kërkesën në pajtim me rregullin 32.4 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit do të publikohet në Gazetën Zyrtare.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


**Gjyqtari raportues**



Almiro Rodrigues



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**



Prof. dr. Enver Hasani